Lezhë, më 12.07.2023

# PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 12.07.2023, në orën 13:00, në sallën e Bibliotekës "At Gjergj Fishta" Lezhë, mbi mbledhjen e këshillit Bashkiak Lezhë.

Mbledhja u hap nga Kryetari z. Nduc Luli, i cili lexoi rendin e ditës dhe më pas e hodhi në votim. Votuan pro të gjithë këshilltarët prezentë, përveç zj. Alfreda Marku dhe z. Sovelgjin Kosova që votuan kundër. (prezentë në mbledhje 30 këshilltarë). Kryetari i dha fjalën zj. Flutura Gjoni, me kërkesë të saj.

Flutura Gjoni: Unë nuk kam si të jem kundër rendit të ditës, por në dokumentacionin që na ka ardhur, në pikën 1 të rendit të ditës, në projektvendim thotë: ..., kryesia e këshillit propozon. Në nenin 22 thuhet që kryesia përbëhet nga kryetari, zv/kryetarët dhe kryetarët e grupeve. Këta akoma nuk janë zgjedhur. Cila kryesi e ka propozuar?

Nduc Luli: Atëherë sqarimi është ky. Unë bashkë me dy zv/kryetarët e kemi parë të domosdoshme të bëjmë disa ndryshime në rregulloren e këshillit të Bashkisë, duke u nisur nga nevojat imediate që do kemi ne për vazhdimësinë e punës tonë, por duke u nisur dhe nga disa pika të rregullores të cilat bien ndesh me mbarëvajtjen e punës së këshillit. Gjatë diskutimit do ta shohim. Iniciativa ka qenë e kryesisë së vogël, siç i themi ne, por kemi thirrur në tre grupe,

të parët e listave. Socialistët e kanë zgjedhur kryetarin e grupit që në mbledhjen e parë, që është Erin Ndreca, për Partinë Socialdemokrate kemi Aris Memën, kemi ngarkuar për "Bashkë Fitojmë" z. Kristian Gjidodaj. Vendimin e marrim këtu. Secili këshilltar ka të drejtë të diskutojë, të japë mendime, argumente pro dhe kundër.

Agostin Marku (zv/kryetar) Më lejoni të shtoj diçka sa për sqarim. Kryesia në çdo rast përbëhet nga 3 të zgjedhurit nga vetë këshilli por edhe nga ajo që theksoni ju znj. Gjoni, nga kryetarët e grupeve të këshilltarëve, të cilët përcaktohen nga vullneti i këshilltarëve dhe ne deri sot kemi të formatuar dy grupe politike pra Kryesia ekziston sot. Nesër do ditohet në numër. Mbas 6 muajsh ndoshta dhe pakësohet. Nuk e kemi ne në dorë se është kryesia. Kështu që nuk ka asgjë joligjore aty që kërkohet propozim nga kryesia.

- kryetari i dha fjalën znj. Alfride Marku me kërkesë të saj.

Alfride Marku: Në radhë të parë, në respekt të qytetarëve që gjithsecili prej nesh përfaqëson, u kërkoj drejtuesve të këshillit që çdo mbledhje të jetë publike dhe drejtpërdrejt e transmetuar në faqen e K.B. Lezhë. për transparencë. Jam dakord me pretendimin e mëparshëm. Është

një projekt vendim për të cilin ne mblidhemi sot me një relacion shpjegues dhe që është propozuar nga një strukturë që nuk është ngritur akoma ashtu siç e përcakton rregullorja. Ju akoma nuk keni vijuar me krijimin e grupeve politike dhe po e zavarrisni këtë fazë, ju bëni një propozim, që në respektim të rregullores është nul. Thatë: jemi në kushtet e emergjencës për këto propozime. Në fakt nuk rezulton ashtu. Sepse po të ishte ashtu do kishim një relacion të saktë e të përpiktë në sqarim të çdo pike që propozoni. Nëse flasim këtu për emergjencë, një dhe kryesore sot është emergjenca për kazanë, mbarëvajtje e sezonit turistik.

- Ndue Lufi: Ta lëmë te "Të ndryshme" të lutem.
- Znj. Alfrida Marku vazhdon diskutimin e saj në lidhje me shqetësimin për sezonin turistik. (furnizimi me ujë të pishëm në Shëngjin, siguria e pushuesve dhe pastërtia në zonën e kuqe)

A.M: Për t'iu rikthyer rendit të ditës. Propozimi im është që të vazhdoni me konstituimin e grupeve politike sepse jemi në kushtet e pamundësisë procedurale dhe politike për të vijuar me shqyrtimin e pikave që keni propozuar.

Jeni mundur pë të bëni një grupim propozimesh
por në fakt problemi është te grupet
politike, jo se ne nuk i kemi 5 këshilltarë,
ama e shoh keqdashëse përpjekjen tuaj për
të rritur doemos minimumin e këshilltarëve
që përbëjnë një grup politik, që të kufizohet
e drejta e një këshilltari për të qenë pjesë e
komisioneve, ku në emër të banorit të marrë,
të mbrojë interesin qytetar, të monitorojë
veprimtarinë e institucionit të bashkisë.
Ideja është kjo, grupi që ka propozuar
këto amendime, nuk ka tagër juridik
që të bëjë propozime të tilla

Ndue Luli: Atëherë sqarimin e parë po e nis
tek kjo e fundit. E thashë më parë, iniciativa
nuk është e neve treshes por edhe dy grupimeve
politike më të mëdha në këtë këshill dhe
është e pesë vetëve në fund të fundit.
Sipas ligjit, me kërkesë të 1/3 së këshilltarëve
mblidhet Këshilli. N.q.s nuk e dini, ta
lexoni. Dhe jo 1/3 por shkon thuajse
2/3, numri i këshilltarëve që kanë kërkuar
këtë mbledhje këshilli, pikërisht për mënyrën
e organizimit të këshillit.

Agostin Marku: Me leje. Meqë më përmende
znj. Marku. Kryesia e këshillit ekziston.
Nuk është në dorën e kryesisë dhe të askujt,

përveçse të këshilltarëve, që të pozicionohen dhe të formohen grupet politike. Këshilltarët sot, mund të vendosin që të mos kenë g. politike. Nuk ekziston kryesia e këshillit? Nuk ka numër të caktuar kryesia e këshillit. Nuk ka vendimmarrje Kryesia e këshillit. Është organ konsultativ.

Mos abuzoni me hapësirën që ju krijohet. Ka një kohë dhe diskutimi për procedurë, por mos i hyr pikave të rendit të ditës dhe mos bëj propagandë.

Ne kemi thënë është emergjencë për anën organizative, për funksionimin normal të këshillit. N.q.s duam t'i bëjmë punën ashtu, që sot do kishim sjellë në projekt vendime për buxhetin, por nuk mund të marrim vendime të tilla pa ngritur strukturat organizative.

Ndaj z kryetar rendi i ditës u miratua me shumicën e votave. Fillojmë dhe kush ka probleme sipas pikave, t'i ngrejë dhe të japë edhe mendime se vetëm mirë bëjnë, që t'i përmirësojmë.

Ndue Luli: Vazhdojmë me pikën e parë të rendit të ditës. që është projekt vendim "Për disa ndryshime në Vendimin nr. 54, datë 28.04.2020 "Për miratimin e rregullores së

Këshillit të Bashkisë Lezhë".
Do zbatojmë rregulloren në lidhje me kohën e diskutimit.
Kush e do fjalën?
Flutura Gjoni: Unë e kam lexuar dhe ka një posaçërisht për mua më duket jo e hijshme.
Neni 7, pika 2.f në fakt është pika 2.i për t'u riformuluar
Neni 7 pika 11 nuk ekziston fare
- Folën dhe dhanë sqarime rreth këtij shqetësimi z. Ndue Luli dhe z. Agostin Marku.
Keqkuptimi ka lindur për shkak të një lapsusi në rregulloren që ndodhet e publikuar në web, të cilën e kanë dhe këshilltarët, ku neni 7 pika 2 ka përmbajtje identike me atë në kopjen zyrtare në zyrën e këshillit, por thjesht ka një lapsus në gërmat e nenit 7/2.
dhe duhet jo neni 7/11 por neni 9/11.
- Artan Ndreu: Në dt. 14 maj ka mbaruar fushata. Nuk kemi ardhur këtu për të ditur se i djathtë apo i majtë është njëri apo tjetri.
- Ndue Luli: Kush ka mendim tjetër në lidhje me projekt vendimin.
- Alfride Marku: Këtu flasim për këshillat komunitare. Nuk mund të paragjykojmë se do zgjidhen burra më shumë ose vetëm burra dhe gra më pak ose aspak gra, pra

pamundësinë që të respektohet kuota gjinore.
kështu që nuk e shoh të arsyeshme që t'i
hapet rrugë përllimisht mosrespektimit të
kuotave gjinore në këshillët komunitare.
Ne duhet të shohim rast pas rasti

Ndue Luli: Disave prej jush iu ka rënë
rasti të shikoni për zgjedhjet e kryetarëve
të lagjeve dhe në ato takime 95%,
për të mos thënë 100%, vetëm burra vijnë.
Jam dakord me atë që thua ti, në parim,
por praktika ka treguar tjetër.
Kemi menduar që në vijim të studiojmë me
kollëz dhe Rregulloren e Strukturave komunitare

Afrida Marku: Është diskriminuese.

Ndue Luli: Fjala "për aq sa është e mundur"
nuk e kufizon.

Artan Ndreu: T'i zgjedhim të gjithë kryeplakë.

Donika Hoxhia: Nuk kemi pse një rast atipik
ta kthejmë në një rast tipik.
Ju keni të drejtë në atë që thoni se e keni
parë nëpër takime në fushata që vijnë më
shumë burra.

Ndue Luli: këtu nuk përmendet asnjëra gjini.

Donika Hoxhia: S. Specialiste gjuhe, ju thoni
që fjala aty legalizon

Agostin Marku: këtu nuk përmenden fjalët
femër e mashkull. N.q.s. e lëmë 50 me 50,

çfarë fitojmë? Sepse në këtë këshill, ku je vetë anëtare, përcaktohet para për kandidojnë 50 me 50, por a i shikon raportet për forcë këtu?
Pjetër Tushaj: Unë nuk kuptoj diçka këtu në lidhje me kryepleqtë, kryeplaku a do caktohet nga populli apo nga një individ mbasë? Të kandidojë kush të dojë dhe të zgjidhet, është e thjeshtë.
Soveljan Kosova: E kuptoj pjesën e kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave, por te neni 15, cila është arsyeja e heqjes së këtyre pikave?
Ndue Duli: Te Neni 15, pikat 17, 18, 19 janë të përsëritura.
Erin Ndreca: Të flasim dhe ne të mazhorancës, sepse të paktën opozita nuk mund të na akuzojë që nuk ka folur.
Mendoj që këshilli është një institucion shumë i rëndësishëm dhe nuk duhet të vijmë këtu dhe të paraqesim tekka personale të fitueseve.
Këtu vihet për të shprehur mendimet dhe pjesëmarrjen duhet ta shohim si vlerë dhe jo si një vend ku të shpallim propagandën tonë politike.
Zoti kryetar, unë të kërkoj që të zbatohet rregullorja.
Është e drejta e fituesit ta japë mendimin e tij por në fund vendos këshilli.

Ndue Luli: kush ka ndonjë mendim tjetër për pikën e parë të rendit të ditës? Mepsë nuk ka, e hedhim projekt vendimin në votim.

- Kush është dakord?

22 këshilltarë votuan PRO

6 vota kundër (Donika Ndoj, Alfrida Marku, Donika Hexhia, Alfons Troshaj, Pjetër Tushaj, Flutura Gjoni)

2 vota abstenim (Emanuel Përjaku, Sovejën Kosova).

- Kalojmë te pika 2 e rendit të ditës që është "Deklarimi dhe formatimi i grupeve politike".

→ Erin Ndrecа: Grupi socialist është ky: 1- Erin Ndreca, kryetar, 2- Reggina Sokolaj, 3- Dod Jaku, 4- Jorida Mikaj, 5- Drimona Marku, 6- Rajmonda Prendaj, 7- Klejvi Hoxhipi, 8- Else Gjetulli, 9- Ndue Luli, 10- Agostin Marku, 11- Marin Suta.

→ Aris Meme: Grupi socialdemokrat është ky: 1- Aris Meme - kryetar, 2- Xhovana Gjelehilaj, 3- Edlir Reçi, 4- Miranda Dodaj, 5- Marko Jaku, 6- Justina Gjeshi, 7- Klevis Bezhi.

→ Donika Ndoj: Grupi "Besëlidhja" është ky: 1- Sovejën Kosova - kryetar, 2- Donika Hexhia,

3- Donike Ndoj, 4- Emanuel Përjaku,
5- Flutura Gjoni, 6- Fjorixhene Zefi,
7- Pjetër Tushaj.

→ Alfrida Marku: Grupi "Partia Demokratike e Shqipërisë" PDSH është ky:
1- Alfrida Marku - kryetare, 2- Rrok Marku,
3- Kristian Gjidodaj, 4- Donin Jaku, 5- Lirim Borba, 6- Alfons Tushaj.

Ndue Luli:
- Vazhdojmë me pikën 3 të rendit të ditës që është projekt vendim "Për miratimin e komisioneve të përhershme të këshillit të Bashkisë Lezhës dhe përbërjes së tyre". Në lidhje me këtë, secili grup politik (që deri tani janë 4 të deklaruar) a ka ndonjë mendim?

Alfrida Marku: Përgjithësisht dakord por kam disa propozime për të cilat unë mendoj se edhe e shtojnë produktivitetin e punës së këshillit, por që i shërben dhe funksionimit të Bashkisë dhe interesave të qytetarëve. Përderisa turizmi është shtylla kryesore e zhvillimit ekonomik të Lezhës, unë mendoj t'i dedikojmë një komision të posaçëm, me të veçantë. Ndihmon edhe në promovim. I dimë të gjitha problemet e sinisë, por duke parë që për fat, këshilli ka kap

shumë të rinj, unë mendoj për edhe rinisë t'i dedikojmë një komision të veçantë.
Tjetër, buxheti dhe zhvillimi ekonomik të jenë të ndarë në komisione të veçanta.
Edhe për Integrimin të kete një komision të veçantë, si dhe komisioni për barazinë gjinore ..., të ndryshohet emërtimi.

- Ndue Luli: Në pikën e parë të rendit të ditës ne e miratuam numrin e komisioneve për u bërë dhjetë, si dhe emërtimet.
- Afrida Marku: Por nuk u shtruan për diskutim. U bë në mënyrë votive.
- Ndue Luli: U bë me votë, jo në mënyrë votive.
- Erin Ndrece: E rëndësishme është që këto komisione i përmbledhin të gjitha problematikat
- Agostin Marku: E ndjej të nevojshme të bëj një sqarim të shkurtër. Këtu jemi. Këto ndryshime janë për të filluar punën. Mbas 6 muajsh mund të na lindë nevojë për ta ndryshuar krejt rregulloren.
Ne tani duhet të shohim këtë vendim për ke 3 pike, pika e parë është emërtimi i komisioneve, e dyta është me 7 anëtarë dhe pjesa e tretë - drejtimi për secilin pozitë - opozitë.

Ju këto probleme shikoni sepse emërtimet
dhe numrin këtu nuk mund t'i ndryshojmë
sepse i biem ndesh vendimit të parë që
morëm.

- Ndue Luli: Grupimet politike u krijuan
dhe do të propozojnë emrat e këshilltarëve
se ku ata mendojnë të jenë në komisione
duke ruajtur raportin pozitë - opozitë.

→ Fjalën e mori z. Erin Ndrece, i cili në
emër të maxhorancës bëri propozimet për
të 10 komisionet.

- Ndue Luli: Vazhdojmë me propozimet e opozitës.

→ Znj. Alfrida Marku pyet në lidhje me ndarjen
për opozitën.

→ z. Agostin Marku jep shpjegime për pozicionin
e kryetarit apo për zv/kryetarin që i takon
në çdo komision si dhe për numrin e
anëtarëve.

- Alfrida Marku: Pse diku kemi 1 anëtar dhe
diku tjetër kemi 2 anëtarë?
Ne duam 2 te bashket

- Erin Ndrece: Mund të propozosh, jo të
kërkosh, e vendos këshilli.

- Ndue Luli: Aty ku ke 3 nga 7, ke 42 %.

→ z. Sokoljan Kosova si kryetar i grupit politik
"Besëlidhja" por z. Ndue Luli u propozon
dy grupeve politike opozitare që të marrin

10 minuta kohë dhe të bëjnë propozime të përbashkëta.
Agostin Marku: Ta dini që dhe ata që nuk janë angazhuar nga opozita do kenë vendet e tyre nëpër komisione.
Ndue Luli: Vazhdojmë.
Dy grupimet që u mblodhën për të dalë me propozime të përbashkëta kanë 13 anëtarë. Por janë dhe 2 këshilltarë të tjerë të cilët janë jashtë grupeve deri tani. Të mendojnë vetë në të ardhmen se ku do të futen.
Në lidhje me komisionet, Aleksandër Mekaj nuk ka dëshirë të jetë në asnjë komision kurse zv/kryetarja Alesia Llesi mendojmë të jetë te komisioni i Barazisë Gjinore.
Nq.s keni mendim tjetër dakord.
(Ndërkohë opozita ka marrë edhe pak kohë për të dalë me propozimet).
- Sovejan Kosava: Herën tjetër kushtojini kujdes atyre që na nisni. E kam me zv/kryetarin më tepër.
- Agostin Marku: Dakord por u miratuan ato.
→ Fjalën e mori z. Alfrida Marku, e cila në emër të opozitës bëri propozimet për të 10 komisionet.
→ z. Agostin Marku i rilexoi për saktësi.
→ z. Ndue Luli hodhi në votim propozimet

e bëra. Të gjitha u miratuan nga të gjithë këshilltarët prezentë.

- Ndue Luli: Kalojmë te pika 4 e rendit të ditës për është projekt vendim "Për heqjen e mandatit si anëtar i Këshillit të Bashkisë Lezhë z. Vinçenc Tuku".

Z. Tuku ka paraqitur aktin noterial të dorëheqjes.

Meqë nuk ka diskutime, e hedhim në votim.

Miratohet nga të gjithë këshilltarët prezentë.

Këshilltari që do e zëvendësojë në këshill, do e zëvendësojë dhe në komisione.

Ju falenderoj për marrjen e këtyre vendimeve.

Kalojmë te pika "Të ndryshme".

→ Folën znj. Flutura Gjoni dhe znj. Afrida Marku.

- Ndue Luli: Meqë nuk ka diskutime të tjera, mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

Ju falenderoj.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI